



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr.Regj.Them 2153
Dt.Regj 23.12.2015

Nr.115. Vendimi
Datë 09.02.2016

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

asistuar prej sekretares gjyqesore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 09.02.2016 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. 2153. Regj.Them, date paraqitje 23.12.2015, që i përket paleve ndergjyqese :

PADITESI: Shoqeria "LUT -MAR " Sh.P.K ,perfaqesuar me administrator Z.Sami HAMZAJ dhe ky I fundit me deklarim ne séance nga ana e ekonomistes se kesaj shoqerie znj.Marsela Karabolli.

I PADITUR: -Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore.(Ne mungese)
-Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane.(Ne mungese)

OBJEKTI: Shfuqizimi i akteve administrative :

a- Njoftim Vleresimi Nr.S'ka .Prot .date 16.09.2015 i Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore.

b-Vendimi me Nr 31949/2 date 25.11.2015 i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

BAZA LIGJORE: -Ligji Nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative " , neni 15 i ketij ligji
-Ligji 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise ".

Gjykata pasi mori provat e nevojeshme,degjoi ne kerkimet perfundimtare palen paditese ne proces e cila u shpreh : Per pranimin e padisë,
Perfaqesuesi I pales se paditur (Ne mungese),por i ka derguar prapesimet e saj me shkrim dhe nepermjet tyre kekron :-Rrezimin e padise;si e analizoi çështjen ne teresine e saj :

V Ë R E N:

Paditësia i është drejtuar gjykatës me anën e padisë së mësipërme duke kerkuar sipas objektit te padise.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata mori ne shqyrtim dhe analizoi fillimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje.

Ne lidhje me kete fakt gjykata ju referua ligjit me nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative "KREUT III te saj (nenit 7,pika b) e saj)/kompetenca lendore/ ne te cilin midis te tjerash citohet se :

Gjykatat administrative jane kompetente per : " Gjykatat administrative jane kompetente per:
a) mosmarrveshjet qe lindin nga aktet administrative individuale, akret nenligjore normative dhe kontratat administrative publike, te nxjerra gjate ushtrimit te veprimtarise administrative nga organi publik;duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarreveshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marredheniet civile mes paleve ndergjyqese". çmoi kryesisht se çeshtja e paraqitur eshte ne juridiksionin lendor te kesaj gjykate.

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar"Kompetenca funksionale" ne te cilin citohet se : " 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nenligjor normative,arriti ne kunkludimin se kjo çeshtje eshte nen kompetencen funksionele te kesaj gjykate.

Ne lidhje me kompetence tokesore kjo gjykate j'u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012"Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" ne te cilin citohet se "1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çeshtje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetem.

Rrethanat e faktit.

Paditesi Sami Hamzaj eshte administrator i vetem i shoqerise"Lut Mar" sh.p.k me aktivitet tregeti me shumice e lendes drusore dhe e materialeve te ndertimit me Nipt K36527233C.

Pre Drejtorise Rajonale te Tatimeve Vlore eshte njoftuar me aktin e dates 16.09.2015,sipas te cilit jameshte gjobitur me shumen 200.000 leke per mosleshim te kuponit tatimor .Ky njoftim vleresim eshte bazuar ne akt konstatimin ne 0481984 date 25.07.2015 te mbajtur nga inspektoret e Drejtorise se Hetimit Tatimor ,sektori i Zbatimit ,Tirane .

Grupi i kontrollit te Drejtorise se Hetimit Tatimor ,sektori i Zbatimit ,Tirane ka qene ne ambjentin e shoqerise sone ne adresen Rruga Hasan Kushta ne date 25.07.2015 ora 10.30 ,dite e shtune ne perfimdimit te inspektimit eshte mbajtur Akt - Konstatimi me nr 0481984 .Ne kohen qe eshte ushtruar kontrolli nuk eshte konstatuar pasur asnje kliente ,apo shitje ne kete ambjent te shoqerise . Midis te tjerash ne Akt-Konstatimi eshte konstatuar se mungonte paisja fiskale sepse ishte per riparim ne servis ,fakt ky i provuar me verteuar me Proces Verbalin e leshuar nga shoqeria BNT ELECTRONICS.Sipas ketij proces verbali paisja eshte derguar per riparim ne date 23.07.2015 dhe eshte mare ne daten e kontrollit ne oren 12.00.

Gjithashtu eshte konstatuar se ne kete ambjet te shoqerise nuk disponoja deftesa tatimore ,por disponoja faturat tatimore te shitjes .

Per kete nga ana e Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore pala paditese eshte gjobitur me 200.000 leke ne baze te pikes 122/01 nenpika "b/i "e ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise "

b) nuk leshon kupon tatimor per qarkullimirt e realizuar te mallrave apo te sherbimeve, per cdo rast konstatimi:

i)per kontrollin e pare, me gjobe, ne masen 200 000 (dyqind mijë) leke, per tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar .

Paditesi duke mos qene ne dakort me kete mase gjobe ka kryer procedure e ankimit administrativ prane Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane dhe prej kesaj te fundit eshte vendosur lenia ne fuqi e vendimit te Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore

Ne rertihana te mesiperme pala paditese i eshte drejtuar kesaj gjykate me padine object gjykimi Brenda afatit ligjor te parashikuar nga neni 18 i ligjit me nr. 49/20012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative".

Parashtrimet e pales paditese

Jam gjobitur per mosleshim kuponi apo deftese tatimore ,nderkohe qe:

1.Nuk ka pse te nenkuptohet se mos paisja me deftese tatimore eshte e barabarte me / mosleshim kuponi, sepse edhe njehere e theksoj se nuk kam qene duke shitur .

Ne mungese te kases nuk kemi kryer fare shitje me leke ne dore.

Ju sqaroj se ne shesim me fatura tatimore se keshtu eshte natyra e biznesit tone .Objekti i veprimtarise sone eshte shitje e pllakave per shtrim .Ka vite qe kjo tregti ka pesuar renie dhe pothuaj se nuk ka fare shitje ne individe .Shitjet tona jane ne subjketet e pakta ndertuese qe ushtrojne tashme aktivitet dhe qe shitja ndaj tyre behet me fatura tatimore dhe likujdimi nepernjjet bankes. Diten e kontrollit ka qene hapur vetem ekspozita e shoqerise dhe nuk kemi kryer shitje edhe per arsyen se mungonte kasa.

2.Ambjenti i kontrollit eshte ekspozite me siperfaqe 38 m2 ,kjo e deklaruar dhe ne QKR 3.Sipas nenit 122 pika 1 germa b/i ndeshkohesh kur : " nuk leshon kupon tatimor per qarkullimin e realizuar te mallrave apo te sherbimeve, per gdo rast konstatimi:dhe jo kur nuk je i paisur me deftese tatimore Ne ambjentin e shoqerise qe jam kontrolluar ne kohen e kontrollit nuk kam kryer shitje ,pra nuk ka qene nevoja te leshoja kupon/deftese tatimore .Gjithashtu dhe asnjehere te vetme ne historikun e shoqerise sime prej 20 vitesh nuk jam ndeshkuar se kam shitur pa fature tatimore apo dhe pa kupon tatimor .

Perfundimisht per arsyet e lartpermendura, kerkojme nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore pranimin e kerkese padise per: "Shfuqizimi I akteve administrative me Nr.S'ka .Prot date 16.09.2015 te DRT Vlore, si dhe vendimi me Nr.31949/2 .Prot. date 25.11.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

Prapesimet e pales se paditur

Ne lidhje me pretendimet e paditesit po prapesojm se:

Shoqeria "Lut Mar" sh.p.k me aktivitet tregeti me shumice e lendes drusore dhe e materialeve te ndertimit me Nipt K36527233C i eshte nenshtuar nje kontrolli nga inspektoret e Hetimit Tatimore Tirane, ne baze te urdhrin te punes me Nr.1834 Prot, date 16.07.2015. Nga pikpanja ligjore kontrolli proceduralisht eshte i mbeshtetur ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar. Pra nga ana procedurale Drejtoria Hetimit Tatimore Tirane legjitimohet plotesisht ne kontrollin e ushtuar ne subjektin "Lut- Mar" sh.p.k.

Mbi bazen e kontrollit te ushtuar ne shoqerin "Lut- Mar" sh.p.k eshte mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0481984 date 25.07.2015 ku rezultoi se "subjekti eshte i regjistruar ne QKR, eshte i pajisur me kase fiskale, por ne daten 23.07.2015 ka paraqitur nje Proces-Verbal qe ka cuar ne servis pajisjen fiskale me nr BN 01000857, por subjekti nuk dispononte deftese per shitjet e kryera, ne momentin e kontrollit ne pune u gjende nje punonjes: Sami Hamzaj Id:F903081676, kontrolli eshte kryer ne or en 10".

Ky akt eshte percjell per verifikime te metejshme ne DRT Vlore. Prej ketej, ne baze te konstatimit te mbajtur eshte mbajtur dhe Proces-Verbal Gjobe me nr. serial 0165837, date 04.09.2015, ku ne baze te Ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" neni 122, pika i germaa (b.1). subjekti eshte penalizuar me gjobe ne masen 200.000 leke per mos leshim kuponi tatimor.

Subjekti është njoftuar për këto penalitet me anë të njoftimit vleresimit nr. prot. date 16.09.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Nga sa mësipër mund të themi se, nënshkrimi i kuponit tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave dhe shërbimeve, përben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjobe në zbatim të nenit 122 të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), sipas të cilit citojme: nenit 122, pika l.b.i:

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet në rast se: b) nuk leshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:

i) për kontrollin e parë, me gjobe, në masën 200 000 (dyqind mijë) leke, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobe, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) leke, për tatimpaguesit e tjerë;

Pretendimi i subjektit është "se e ka dërguar pajisjen fiskale për riparim në shoqërinë BNT 01000857 në datën 23.07.2015 dhe në orën 12 të ditës së kontrollit e kishte marrë nga shoqëria, ambienti ku ushtron veprimtarinë shoqëria është një ekspozitë, dhe nuk është nevoja për të leshuar kupon / deftesë tatimore dhe se ai s'het mefaturë tatimore shitje".

Nga kontrolli në vend është konstatuar se subjekti është i pajisur me kase fiskale (për të dokumentuar shitjet me leke në dorë), dhe në momentin e kontrollit kasa fiskale ka qenë për riparim në shoqërinë BNT, nga shqyrtimi i argumentave, subjekti nuk dispononte deftesa tatimore për të përdorur në mungesë të pajisjes fiskale (kuponit tatimor) për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave, në zbatim të nenit të sipërcituar.

Sipas Udhezimit nr. 16. dt. 03.05.2010, "Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale", pika 19. Përdorimi i deftesave tatimore në rastet e mosfunksionimit të perkohshëm të pajisjeve fiskale, përcaktohet se: "Në rastet e mosfunksionimit të perkohshëm të pajisjeve fiskale, të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin deftesën tatimore për çdo shitje me pakicë që realizojnë. Blloku me deftesa tatimore do të furnizohet nga drejtoritë rajonale tatimore dhe do të jetë me nr. serial (modeli bashkëngjitur udhezimit)".

Nga sa mësipër lidhur me detyrimin për të instaluar dhe përdorur pajisjet fiskale, referuar Ligjit 9920 dt. 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore", nenit 55 "Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale", thekson: 1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankes, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për leshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.781, dt. 14.11.2007 pika 1 thuhet: "Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise, apo njësi të përhershme të hapura për publikun, instalojnë pajisje fiskale dhe leshojnë kupone tatimor për çdo transaksion".

Për shqyrtimin e gjobes në shumën 200.000 leke, i referohemi dhe Nenit 111 "Denimet administrative" pika 4, të Ligjit nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar ku është përcaktuar se: "Gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi natyrore apo rrethana të tjera, të jashtëzakonshme, si vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore". Pretendimi i shoqërisë për faljen e gjobes nuk është pjesë e kushteve të parashikuara në dispozitën e mësipërme për heqjen e gjobave.

Referuar fakteve të mësipërme kërkojmë rrezimin e kërkesë padisë dhe lenien në fuqi të aktit administrativ njoftim vleresimit tatimor nr. ska prot. dt. 16.09.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë si dhe Vendimin nr. 31949/2 dt. 25.11.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, si akte të nxjerra në zbatim të ligjit dhe konform të gjitha procedurave tatimore.

Ligji i Aplikueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se: *"Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj"*.

Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore: *"Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar"*.

Për sa më sipër, vendimi objekt shqyrtimi do të trajtohet nga gjykata si cdo akt administrativ. Në nenin 15 të ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet, se: *Te drejten e padisë e ka çdo subject, që pretendon se I është cenuar një e drejtë apo një interes I ligjshëm nga një veprim apo mosveprim I organit public;*

"Padia, sipas nenit 17 të këtij Ligji mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive..."

-L I G J Nr.9920, Datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" I Ndryshuar.

Zgjidhja ligjore

Gjykata në lidhje me barren e proves , ka për reference nenin 35 të ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"-Barra e proves në të cilin citohet se: *"1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimitarisë së kundërshtuar në gjykatë."*

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit "Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.", arrin në konkluzionin se padia duhet pranuar për arsyet si më poshtë vijon:

Nga hetimi gjyqësor i kësaj çështje rezultoi e provuar se Shoqëria tregtare "Lut-Mar"sh.p.k ushtron aktivitetin tregtar, tregeti me shumice dhe pakice në lende drusore dhe e materialeve të ndertimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore me anë të Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Nr.s'ka,date 16.09.2015 ka njoftuar shoqërinë paditëse detyrimet tatimore në zbatim të kërkesave të Ligjit 9920/2009 "Për Procedurat Tatimore" për vendosjen e gjobes në vlerën 200.000 leke detyrim që rrjedh

si rezultat i gjobes te vendosur nga ana e inspektoratit te kryer prej inspektoreve te Drejtorise se hetimit tatimor Tirane ne ambiente te dyqanit te kesaj shoqerije me date 25.07.2015.

Pala paditese ka bere ankim administrativ ndaj ketij Njoftimi Vleresimi per detyrimet duke i drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimor. Me ane te Vendimit Nr.31949/2, date 25.11.2015. Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur lenien ne fuqi te Njoftimit Nr. S'ka date 16.09.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore.

Paditësi, duke mos qenë dakord me këto vendime, i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Nr. S'ka, date 16.09.2015 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore dhe te aktit administrativ Vendimit Nr. Nr.31949/2, date 25.11.2015 leshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme se Tatimeve.

Pala paditese ka pretenduar se Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. S'ka, date 16.09.2015 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore se është në kundërshtim me ligjin. Sipas palës paditese : Jam gjobitur per mosleshim kuponi apo deftese tatimore ,nderkohe qe: 1.Nuk ka pse te nenkuptohet se mos paisja me deftese tatimore eshte e barabarte me / mosleshim kuponi, sepse edhe njehere e theksoj se nuk kam qene duke shitur .

Ne mungese te kases nuk kemi kryer fare shitje me leke ne dore. Ne ambjentin e shoqerise qe jam kontrolluar ne kohen e kontrollit nuk kam kryer shitje ,pra nuk ka qene nevoja te leshoja kupon/deftese tatimore .

Pala e paditur ka pretenduar se administrata tatimore ka ndjekur të gjithë procedurën që parashkon Ligji 9920/2009 “Per Procedurat Tatimore”. Inspektorët kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë paditese dhe aty kanë konstatuar se kjo shoqëri ka realizuar shitje pa leshuar kuponin tatimor.

Neni 122 Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:

b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

Nga Akt Konstatimi 0155908 datë 17.08.2011 mbajtur nga Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë rezulton se ato kanë ushtruar një kontroll në shoqërine Mela sh.p.k në Tiranë. Mbas këtij kontrolli ato kanë konstatuar se në këtë subject janë gjetur shkelje të Ligjit 9920/2009 “Per Procedurat Tatimore”. Ka rezultuar se ne këtë subject në momentin e kontrollit është lëshuar kupon tatimor për shërbimet e kryera. Për këtë arsye pala paditese është gjobitur në shumën 100.000 Lekë.

Nga Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. S'ka, date 16.09.2015 leshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore rezulton se DRT Tiranë ka njoftuar palën paditese për detyrimet tatimore në zbatim të kërkesave të Ligjit 9920/2009 “Per Procedurat Tatimore”. Ky detyrim është i përbërë nga gjobat që inspektorët e palës së paditur DRT Vlore kanë vendosur gjobe për mos lëshim kuponi tatimor në shumën 200.000 Lekë.

Nga Vendimi Nr. 31949/2, date 25.11.2015 leshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme se Tatimeve rezulton se ky organ apelimi administrativ ka lenë ne fuqi

Njoftimin e Vlerësimit për Detyrimet Nr. S'ka. date 16.09.2015 lëshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, pra po me argumentin se mosleshimi i kuponit tatimor perben k/vjtje administrative dhe denohet me gjobe ne masen 200.000 leke.

Nga procesi gjyqësor, Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. Date 16.09.2015 lëshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore dhe Vendimi Nr.31949/2, date 25.11.2015 i dhene nga Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme se Tatimeve rezultojne me probleme ligjore thelbesore dhe proceduriale. Keto organe administrative kanë nxjerrë këto akte administrative me pasoja jo të vogla për paditësin dhe nuk ka dhënë arsyetim bindës apo provë mbështetese.

Referuar process-verbalit te konsttaimit te mbajtuar me date 25.07.2015 prej punonjesve te Drejtorise se Hetimit tatimor Tirane eshte i pasqyruar fakti se : Mbi bazen e kontrollit te ushtruar ne shoqerin "Lut- Mar" sh.p.k eshte mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0481984 date 25.07.2015 ku rezultoi se "subjekti eshte i regjistruar ne QKR, eshte i pajisur me kase fiskale, por ne daten 23.07.2015 ka paraqitur nje Proces-Verbal qe ka cuar ne servis pajisjen fiskale me nr BN 01000857, por subjekti nuk dispononte deftese per shitjet e kryera, ne momentin e kontrollit ne pune u gjende nje punonjes: Sami Hamzaj Id:F903081676, kontrolli eshte kryer ne or en 10".

Ky akt eshte perezjell per verifikime te metejshme ne DRT Vlore. Prej ketej, ne baze te konstatimit te mbajtur eshte mbajtur dhe Proces-Verbal Gjobe me nr. serial 0165837, date 04.09.2015, ku ne baze te Ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" neni 122, pika 1 germa (b,i), subjekti eshte penalizuar me gjobe ne masen 200.000 leke **per mos leshim kuponi tatimor.**

Inspektorët e palës së paditur kanë pretenduar se shoqëria "Lut-Mar" sh.p.k nuk ka lëshuar kupona tatimor. Në këtë rast është përpiluar një akt konstatimi dhe më pas është lëshuar Njoftim i Vlerësimit të Detyrimeve Tatimore. Mirëpo pretendime të tilla nuk mund të lihen vetëm në kuadrin e konstatimit por edhe duhet provuar në formë të plotë shkresore. Çështja e mosleshimit te kuponit tatimor është një pretendim që nuk provohet nga pala e paditur.

Qe te ndodhemi perpara kektij fakti duhet qe te jryhej nje shitje konkrete kudrejt nje subjekti fizim apo juridik dhe kjo shitje te msoshoerohet me leshimin e kuponit tetimor prej shitesit.Pra pala paditese nuk provon-se eshte kryer nje shitje e cila nuk eshte e shoqeruar me kupon tatimor,pasi nese do te is hi vertete ky fakt duhej te penalizohej edhe blesesi i cili nuk ka kerkuar te pajisej me kuponin tatimor.

Inspektorët e palës së paditur nuk kanë paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Kjo mënyrë konstatimi tejkalon procedurat normale të kontrollit ligjor sipas legjislacionit përkatës. Kjo formë kontrolli shkon drejt abuzimit dhe arbitraritetit. Pala e paditur ka perd etyre te pasqyroje sakte ne process-veral faktin konkret dhe jo ate te eventual/te supozuar se kryhet shitje e pa shoqeruar me kupon tatimor.Pra,nuk kemi nje fakt te ndodhur qe te aplikohet kundrejt paditesit shkalja administrative e atrubuar ketij subjekti.

Nga të gjitha këto akte shkresore me vlerë të plotë provuese rezulton se shoqëria Mela sh.p.k ka dokumentuar në përputhje me legjislacioni përkatës të gjithë aktivitetin e saj. Pala e paditur pa te drejtë dhe pa dhënë asnjë argument bindës i ka konsideruar disa fakte të paplota si të shkelje administrative dhe ka llogaritur një detyrim financiar të padrejtë ndaj kësaj shoqërie. Inspektorët pa u informuar në mënyrë të plotë dhe përfundimtare kanë vendosur për të gjobitur palën paditëse. Pretendimet e palës së paditur në lidhje me kuponat tatimor nuk janë provuar në asnjë moment gjatë procesit gjyqësor. Nga akti i konstatimit rezultojnë pasaktësi të dukshme. Nuk vërtetohet në asnjë moment nëse shoqëria paditëse ka kryer shitje dhe këto shitje kryhen apo jo me kupona tatimor. Pavarësisht shënimeve përkatëse të inspektorëve në aktin e konstatimit, në këtë akt nuk janë hedhur në mënyrë të plotë dhe korrekte shkeljet e mundshme të gjetur tek shoqëria paditëse. Vetëm shënimi se

nuk janë lëshuar kupona tatimor nuk përbën shkelje apriori. Cdo kundravajtje administrative duhet të evidentohet dhe të provohet në mënyrë të plotë.

Gjykata cmon se aktet administrative objekt gjykimi vijnë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj duke i bërë këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative si dhe të Ligjit për Kundravajtjet administrative. Gjykata anulon këto akte administrative, konkretisht Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Nr. S'ka date 16.09.2015 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore dhe anulimin e aktit administrativ Vendimit Nr. 31949/2, date 25.11.2015 lëshuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Arsyetimi i këtyre akteve nuk i pergjigjet në vendimarrje rrethanave konkrete dhe për rrjedhojë arsyetimi i tyre nuk është në përputhje me legjislacionin tatimor.

Sa me sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e shoqërisë "Lut-Mar" sh.p.k është mbështetur në ligj dhe në prova dhe, si rrjedhojë e kësaj mbështetjeje të plotë, ajo duhet pranuar.

Vlen të theksohet se ku vendim në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative » nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

...
b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

Rezulton se në rastin konkret masa e denimit administrativ kundrejt paditeit ka qenë në masën 200 mijë leke dhe për rrjedhojë ndaj këtij vendimi nuk mund të kryhet ankim

PER KETO ARSYE :

Gjykata, bazuar në nenin 126 dhe 310 të K.Pr.Civile dhe nenin 40, 42 të ligjit nr.49/2012 nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":

VENDOSI:

-Pranimin e padisë:

- Shfuqizimi i akteve administrative :

a) Njoftim Vleresimi Nr.S'ka .Prot .date 16.09.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlore.

b) Vendimi me Nr 31949/2 date 25.11.2015 i Drejtorisë së Apelit Tatimor Tirane.

-Shpenzimet gjyqesore palet se paditur..

Ky vendim në referencë të nenit 45/ç të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" është i formës së prerë.

U Shpall, në Vlorë sot me datë 09.02.2016

SEKRETARE

Anil Rista



GJYQTARI

Astrit Shema



SHPENZIMET GJYQESORE

Takse padie 3.000 leke

Njoftim 200 leke

Shuma totale 3200 leke

